




Ju jeni të sapoardhur në kantonin Appenzell Ausserrhoden. NE JU THEMI JUVE MIRËSEARDHËT PËRZEMËRSISHT.



Ne ju përshëndetim në kantonin Appenzell Ausserrhoden. Në **bisedën e parë të informimit** ne ju informojmë mbi kushtet e jetës, **të drejtat dhe detyrimet tuaja** si dhe për oferta për të huaja dhe për të huaj.
Këto informacione ju ndihmojnë juve, të orientoheni në mjedisin e ri dhe në kantonin e ri të banimit tuaj.

Ne bisedojmë, përveç kësaj, mbi **nevojën tuaj personale të informacionit** në temat e sistemit të arsimimit, fushës së shëndetësisë, fushës së sigurimeve, punës dhe taksave, kurseve të gjuhës etj. Si funksionon sistemi i arsimimit? Si funksionin bota e punës ose si gjeni ju punë? Çfarë është një arkë e sigurimit shëndetësor? Cilat sigurime duhet të lidhni? Çfarë janë taksat? Ku mund të mësoni gjermanisht? Ne mund t'ju ndërmjetësojmë oferta konkrete.



Kontrollet e banorëve përcaktojnë me ju një **termin për bisedën e parë të informimit** në kuadrin e procesit të regjistrimit. Biseda zgjat një orë dhe kryhet nga Vendi i informimit për integrimin "INFI" në Herisau (Shih faqen mbrapa për adresën).

Në rast të njohurive të pamjaftueshme të gjermanishtes "INFI" do t'ju organizojë një person përkthyes, i cili përkthen në gjuhën tuaj. Kjo është falas për ju.

Në rast se ju duhet të shtyni terminin e caktuar, ju lutemi që të na i njoftoni në kohë këtë, në mënyrë që ne të mund të anulojmë në kohë porosi të mundshme përkthimesh. Nuk duhet të shkaktohen kosto të panevojshme. **Çregjistrohuni nga termini pa përkthyes së paku 24 orë paraprakisht dhe nga terminë me përkthyes së paku 48 orë paraprakisht (përmes telefonit 071 353 64 61 ose me anë të e-mailit infi@ar.ch).**



Termini për bisedën e informacionit të parë është i papërsëritshëm dhe bën pjesë në procesin e regjistrimit. Nëse keni një vend pune, ju lutemi që të informoni punëdhënësen tuaj, punëdhënësin tuaj, për terminin e caktuar. Në rast të terminëve të humbura/të pajustificuar, "INFI" do t'ju kontaktojë sidoqoftë nëpërmjet vendit tuaj të punës.



Vendi i informimit për integrimin "INFI" ju qëndron në dispozicion edhe pas bisedës si pikë kontakti dhe iu përgjigjet pyetjeve tuaja. Në faqen tonë të uebit ju gjeni gjithashtu informacione të dobishme, www.leben-in-ar.ch